

V E N D I M
PËR REGJISTRIMIN E PERSONIT JURIDIK

Sot më datë 20-07-2004, unë M. Deda Gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, mora në shqyrtim kërkesën e kërkuetit, Z. Rezart Taçi, me cilësinë e Drejtorit të Shoqërisë Tregtare "BT International Engineering Services Limited & Arun Construction Joint Stock Company" Sh.a., i cili më kërkoi regjistrimin e kësaj shoqërie si Person Juridik Privat,

KONSTATOVA SE:

Kërkueti, Z.Rezart Taçi, me cilësinë e Drejtorit të Shoqërisë Tregtare në formim e sipër, "BT International Engineering Services Limited & Arun Construction Joint Stock Company" Sh.a., kërkon të regjistrojë Shoqërinë Tregtare "BT International Engineering Services Limited & Arun Construction Joint Stock Company" Sh.a. me seli në qytetin e Tiranës, me adresë Rruga "Dëshmorët e 4 Shkurtit", Pall. "Sky Tower", Ap. No. 6, me objekt të veprimtarisë së shoqërisë:

- Eksport – importi i karburantëve dhe nënprodukteve të tyre, hidrokarbureve në përgjithësi;
- Përpunim, rafinim i naftës dhe nëpëroducteve të saj;
- Shitje me pakicë të karburanteve të të gjitha llojeve;
- Blerjen, importimin, eksportim, shitjen e naftës, gazit, nënprodukteve të tyre, dhe vajrave mineralë të papërpunuar;
- Blerjen, importimin, eksportimin, transportimin, edhe për llogari të të tretëve, depozitimin, përzierjen, trajtimin, shitjen, shpërndarjen me shumicë të qymyrit, gazit, lubrifikantëve, produkteve të naftës dhe naftokimike, duke përfshirë këtu dhe bitumet;
- Blerjen, shitjen, qeradhënien, ndërtimin dhe administrimin e impianteve, depozitave dhe administrimin e ndërtesave dhe pasurive të veta të paluajtshme;
- Gjithashtu shoqëria do të mund të kryejë të gjitha ato veprime që organet drejtuese i konsiderojnë të nevojshme, ose të dobishme për arritjen e qëllimit të shoqërisë, përfshi këtu edhe lëshimi i dorëzanive dhe i garancive të tjera.

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj pas marrjes dhe në përputhje me licensat apo lejet përkatëse.

Kapitali themeltar i nënshkruar i shoqërisë është në vlerën 2 000 000 (dy milion) Lekë, i ndarë në 2000 aksione me vlerë nominale të një aksioni 1000 Lekë .

Aksionerë themelues të Shoqërisë Tregtare "BT International Engineering Services Limited & Arun Construction Joint Stock Company" Sh.a. do të jenë zotërinjtë Rezart Taçi, Omer

Satin, Riza Aydin Arun dhe Sinan Yashar Abdula me pjesmarrje në kapitalin themeltar si më poshtë:

1. Zoti Rezart Taçi, zotëron 40 %, të vlerës së aksioneve në kapitalin fillestar të Shoqërisë të barabartë me 800 numër aksionesh.
2. Zoti Ömer Satin, zotëron 40 %, të vlerës së aksioneve në kapitalin fillestar të Shoqërisë të barabartë me 800 numër aksionesh.
3. Zoti Riza Aydin Arun, zotëron 15 %, të vlerës së aksioneve në kapitalin fillestar të Shoqërisë të barabartë me 300 numër aksionesh.
4. Zoti Sinan Yashar Abdula, zotëron 5 %, të vlerës së aksioneve në kapitalin fillestar të Shoqërisë të barabartë me 100 numër aksionesh.

Afati i veprimtarisë së Shoqërisë është me kohëzgjatje me afat kohor të pakufizuar.

Shoqëria në momentin e themelimit të saj ka zgjedhur edhe organet e para drejtuese. Këshilli Mbikqyrës i përbërë nga tre anëtarë, Zotërinjtë Ömer Satin, Mustafa Taçi dhe Drita Aliçka.

Drejtori i shoqërisë është Z. Rezart Taçi.

Eksperti kontabël i autorizuar Z. Paqsor Qato.

Për sa më sipër kërkesa e paraqitur është plotësisht e bazuar në ligj dhe si e tillë duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE:

Në bazë të ligjit nr.7638 datë 10.11.1992 “Për Shoqëritë Tregtare” e ligjit nr.7667 datë 28.01.1993 “Për Regjistrin Tregtar”,

V E N D O S A:

Të regjistrojë si Person Juridik Privat Shoqërinë Tregtare “BT International Engineering Services Limited & Arun Construction Joint Stock Company” Sh.a. me seli në qytetin e Tiranës, me adresë Rruga “Dëshmorët e 4 Shkurtit”, Pall. “Sky Tower”, Ap. No. 6, me objekt të veprimtarisë së shoqërisë:

- Eksport – importi i karburantëve dhe nënprodukteve të tyre, hidrokarbureve në përgjithësi;
- Përpunim, rafinim i naftës dhe nëpëroducteve të saj;
- Shitje me pakicë të karburanteve të të gjitha llojeve;
- Blerjen, importimin, eksportim, shitjen e naftës, gazit, nënprodukteve të tyre, dhe vajrave mineralë të papërpunuar;
- Blerjen, importimin, eksportimin, transportimin, edhe për llogari të të tretëve, depozitimin, përzierjen, trajtimin, shitjen, shpërndarjen me shumicë të qymyrit, gazit, lubrifikantëve, produkteve të naftës dhe naftokimike, duke përfshirë këtu dhe bitumet;
- Blerjen, shitjen, qeradhënien, ndërtimin dhe administrimin e impianteve, depozitave dhe administrimin e ndërtesave dhe pasurive të veta të paluajtshme;
- Gjithashtu shoqëria do të mund të kryejë të gjitha ato veprime që organet drejtuese i konsiderojnë të nevojshme, ose të dobishme për arritjen e qëllimit të shoqërisë, përfshi këtu edhe lëshimi i dorëzanive dhe i garancive të tjera.

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj pas marrjes dhe në përputhje me licensat apo lejet përkatëse.

Kapitali themeltar i nënshkruar i shoqërisë është në vlerën 2 000 000 (dy milion) Lekë, i ndarë në 2000 aksione me vlerë nominale të një aksioni 1000 Lekë

Aksionerë themelues të Shoqërisë Tregtare "BT International Engineering Services Limited & Arun Construction Joint Stock Company" Sh.a. do të jenë zotërinjtë Rezart Taçi, Ómer Satin, Riza Aydın Arun dhe Sinan Yashar Abdula me pjesmarrje në kapitalin themeltar si më poshtë:

1. Zoti Rezart Taçi, zotëron 40 %, të vlerës së aksioneve në kapitalin fillestar të Shoqërisë të barabartë me 800 numër aksionesh.
2. Zoti Ómer Satin, zotëron 40 %, të vlerës së aksioneve në kapitalin fillestar të Shoqërisë të barabartë me 800 numër aksionesh.
3. Zoti Riza Aydın Arun, zotëron 15 %, të vlerës së aksioneve në kapitalin fillestar të Shoqërisë të barabartë me 300 numër aksionesh.
4. Zoti Sinan Yashar Abdula, zotëron 5 %, të vlerës së aksioneve në kapitalin fillestar të Shoqërisë të barabartë me 100 numër aksionesh.

Afati i veprimtarisë së Shoqërisë është me kohëzgjatje me afat kohor të pakufizuar.

Shoqëria në momentin e themelimit të saj ka zgjedhur edhe organet e para drejtuese. Këshilli Mbikqyrës i përbërë nga tre anëtarë, Zotërinjtë Ómer Satin, Mustafa Taçi dhe Drita Aliçka.

Drejtori i shoqërisë është Z. Rezart Taçi.

Eksperti kontabël i autorizuar Z. Paqsor Qato.

Kundër vendimit lejohet ankim sipas ligjit.

GJYQTARE

Mariame Dedaj
[Signature]

**AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË ANONIME
ME SELI NË TIRANË**



**"BT INTERNATIONAL ENGINEERING SERVICES LIMITED
&
ARUN CONSTRUCTION JOINT STOCK COMPANY" SH.A**

Sot, më datë 09.07.2004, me cilësinë e aksionerëve themelues:

1. Rezart Taçi, i biri i mustafait, i datëlindjes 07.06.1971, lindur dhe banues në Tiranë, në adresën Rruga "Dervish Hima", Pall. "Klan", person madhor me zotësi të plotë juridik për të vepruar, mbajtës i pasaportës me nr. 1899916.
2. Ömer Satin, i biri i Hysein, shtetas turk, i datëlindjes 10.02.1955, lindur në Ankara (Turqi) dhe banues në Stamboll (Turqi), person madhor me zotësi të plotë juridik për të vepruar, mbajtës i pasaportës me nr. 290374.
3. Riza Aydin Arun, i biri i Muharremit, shtetas turk, i datëlindjes 26.11.1949, banues në Stamboll (Turqi), person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportës me nr.467722, përfaqësuar me autorizim të përgjithshëm nr. 32729, datë 01.11.2002 nga Z. Ömer Satin.
4. Sinan Yashar Abdula, i biri i Yashar dhe Perini, shtetas turk, i datëlindjes 1973, lindur në Bagdat dhe banues në Stamboll (Turqi), person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportës me nr. H 0310909, përfaqësuar me autorizim nr. 28447, datë 08.12.2003 nga Z. Ömer Satin.

si themelues të Shoqërisë Anonime "BT International Engineering Services Limited & Arun Construction Joint Stock Company" Sh.a, kanë vendosur sa më poshtë:

NENI 1

Të themelojnë Shoqërinë Tregtare "BT International Engineering Services Limited & Arun Construction Joint Stock Company" Sh.a. në formën e një Shoqërie Anonime pa oferte publike. Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria kundrejtuar të tretëve si dhe në të gjitha aktet e brendshme të saj, do të shënohet detyrimisht emri "BT International Engineering Services Limited & Arun Construction Joint Stock Company" Sh.a., sipas përcaktimeve të bëra në këtë Akt Themelimi dhe Statut.

NENI 2

Qëllimi i krijimit të Shoqërisë.

Qëllimi i krijimit të kësaj Shoqërie është zhvillimi i aktivitetit ekonomik në fusha të ndryshme.

Veprimtaria e kësaj Shoqërie do të jetë thellësisht me karakter ekonomik dhe qëllim fitimprurës.

Si qëllim final Shoqëria do të ketë realizimin e veprimtarisë ekonomike dhe nëpërmjet saj do të synojë realizimin e tregueseve ekonomike dhe social.


NENT3

Emri dhe vula e shoqërisë

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin “BT International Engineering Services Limited & Arun Construction Joint Stock Company”sh.a.
Ajo do të ketë edhe vulën e saj.

NENI 4

Objekti i veprimtarisë

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë:

- Eksport – importi i karburantëve dhe nënprodukteve të tyre, hidrokarbureve në përgjithësi;
- Përpunim, rafinim i naftës dhe nëpëroducteve të saj;
- Shitje me pakicë të karburanteve të të gjitha llojeve;
- Blerjen, importimin, eksportim, shitjen e naftës, gazit, nënprodukteve të tyre, dhe vajrave mineralë të papërpunuar;
- Blerjen, importimin, eksportimin, transportimin, edhe për llogari të të tretëve, depozitimin, përzierjen, trajtimin, shitjen, shpërndarjen me shumicë të qymyrit, gazit, lubrifikantëve, produkteve të naftës dhe naftokimike, duke përfshirë këtu dhe bitumet;
- Blerjen, shitjen, qeradhënien, ndërtimin dhe administrimin e impianteve, depozitave dhe administrimin e ndërtesave dhe pasurive të veta të paluajtshme;
- Gjithashtu shoqëria do të mund të kryejë të gjitha ato veprime që organet drejtuese i konsiderojnë të nevojshme, ose të dobishme për arritjen e qëllimit të shoqërisë, përfshi këtu edhe lëshimi i dorëzanive dhe i garancive të tjera.


Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj pas marrjes dhe në përputhje me liçensat apo lejet përkatëse.

NENI 5

Selia e Shoqërisë dhe afati

Selia e Shoqërisë do të jetë në Qytetin e Tiranës, në adresën Rruga “Dëshmorët e 4 Shkurtit”, Pall. “Sky Tower”, Ap. nr. 6.

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetet për një afat kohor të pacaktuar.



NENI 6

Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi në të holla i aksionerëve themelues të kësaj Shoqërie.

Kontributi në para do të jetë i përbërë nga shuma prej 2.000.000 lekë, që është edhe vlera minimale e kapitalit themeltar për shoqëritë pa oferte publike, shumë e derdhur tërësisht në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate themelimi nga aksionerët themelues të kësaj Shoqërie.

Kapitali i shoqërisë është depozituar në Bankën "Banka Amerikane e Shqipërisë" me seli në Tiranë në llogarinë "Shoqëri në Formim e Sipër" dhe në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate themelimi. Pas regjistrimit, kjo shumë do të kalojë në llogarinë e kësaj shoqërie që do të çelet pranë Bankës "Banka Amerikane e Shqipërisë". Në llogarinë e shoqërisë çelet llogaria "fondi themeltar i aksionerit", ku regjistrohet vlera e kapitalit të tyre.

NENI 7

Kapitali themeltar është i ndarë në 2 000 aksione me vlerë nominale prej 1 000 lekë. Aksionerët themelues të Shoqërisë Tregtare "BT International Engineering Services Limited & Arun Construction Joint Stock Company" Sh.a zotërojnë aksionet në këtë shoqëri si më poshtë:

1. Zoti Rezart Taçi, zotëron 40 %, të vlerës së aksioneve në kapitalin fillestar të Shoqërisë të barabartë me 800 numër aksionesh.
2. Zoti Ömer Satin, zotëron 40 %, të vlerës së aksioneve në kapitalin fillestar të Shoqërisë të barabartë me 800 numër aksionesh.
3. Zoti Riza Aydın Arun, zotëron 15 %, të vlerës së aksioneve në kapitalin fillestar të Shoqërisë të barabartë me 300 numër aksionesh.
4. Zoti Sinan Yashar Abdula, zotëron 5 %, të vlerës së aksioneve në kapitalin fillestar të Shoqërisë të barabartë me 100 numër aksionesh.

NENI 8

Organet drejtuese të shoqërisë janë:


Asambleja e Aksionerëve, e cila përfaqësohet nga aksionerët themelues të shoqërisë dhe përfaqëson në këtë Asamble vlerën e përgjithshme të aksioneve në kapitalin themeltar të Shoqërisë.

NENI 9

Drejtoria e Shoqërisë

Drejtoria e Shoqërisë përbëhet nga Drejtori Ekzekutiv.

Drejtori Ekzekutiv emërohet për një periudhë kohe 6 vjeçare. Drejtori Ekzekutiv i shoqërisë zgjidhet nga Këshilli Mbikqyrës, për periudhën kohore të shprehur si më sipër.



Drejtor Ekzekutiv i Shoqërisë "BT International Engineering Services Limited & Arun Construction Joint Stock Company" Sh.a., do të jetë zoti Rezart Taçi.

NENI 10

Këshilli Mbikqyrës

Këshilli Mbikqyrës i Shoqërisë përbëhet nga tre antarë, të cilët janë caktuar si më poshtë:

1. Ömer Satin;
2. Mustafa Taçi;
3. Drita Aliçkaj.

Kohëzgjatja e antarëve të Këshillit Mbikqyrës do të jetë jo më shumë se tre vjet. Ata kanë të drejtë të rizgjidhen.

NENI 11

Ekspert kontabël të autorizuar të shoqërisë do të emërohen në përputhje me ligjet në fuqi dhe për çdo vit financiar të ushtrimit të veprimtarisë së shoqërisë. Shoqëria do të ketë një ekspert kontabël.

Eksperti i parë kontabël i autorizuar do të jetë eksperti Paqsor Qato.

NENI 13


Shoqëria do të përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqsor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga Z. Rezart Taçi dhe Ömer Satin, të cilat i ushtrojnë këto të drejta të dy së bashku apo secili veç e veç.

NENI 12

Organizimi dhe funksionimi, i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e statutit.


AKSIONERËT THEMELUES

Rezart TAÇI




Riza Aydın ARUN
Përfaqësues me prokurë

Ömer SATIN




Ömer SATIN



Sinan Yashar ABDULA
Përfaqësues me prokurë

Ömer SATIN






REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMË E NOTERISË TIRANË
Nr. 8384 Rep.
Nr. 517 Kol.

VËRTETIM

Sot më datë 09.07. 2004, para meje noterit Agim Robo, Noter pranë Dhomës së Noterisë Tiranë, u paraqiten personalisht Rezart Taçi, i biri i mustafait, i datëlindjes 07.06.1971, lindur dhe banues në Tiranë, në adresën Rruga "Dervish Hima", Pall. "Klan", person madhor me zotësi të plotë juridik për të vepruar, mbajtës i pasaportës me nr. 1899916, Ömer Satin, i biri i Hysein, shtetas turk, i datëlindjes 10.02.1955, lindur në Ankara (Turqi) dhe banues në Stamboll (Turqi), person madhor me zotësi të plotë juridik për të vepruar, mbajtës i pasaportës me nr. 290374, te cilet më deklaruan përmbajtjen e këtij akti të hartuar jashtë kësaj zyre dhe të nënshkruar me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë dhe unë noteri e vërtetova atë sipas ligjit.

NOTER

Agim ROBO



**STATUTI
I
SHOQËRISË ANONIME
ME SELI NË TIRANË**



**"BT INTERNATIONAL ENGINEERING SERVICES LIMITED
&
ARUN CONSTRUCTION JOINT STOCK COMPANY" SH.A**

Sot, më datë 09.07.2004, me cilësinë e aksionerëve themelues:

1. Rezart Taçi, i biri i mustafait, i datëlindjes 07.06.1971, lindur dhe banues në Tiranë, në adresën Rruga "Dervish Hima", Pall. "Klan", person madhor me zotësi të plotë juridik për të vepruar, mbajtës i pasaportës me nr. 1899916.
2. Ömer Satin, i biri i Hysein, shtetas turk, i datëlindjes 10.02.1955, lindur në Ankara (Turqi) dhe banues në Stamboll (Turqi), person madhor me zotësi të plotë juridik për të vepruar, mbajtës i pasaportës me nr. 290374.
3. Riza Aydın Arun, i biri i Muharrem, shtetas turk, i datëlindjes 26.11.1949, banues në Stamboll (Turqi), person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportës me nr. 467722, përfaqësuar me autorizim të përgjithshëm nr. 32729, datë 01.11.2002 nga Z. Ömer Satin.
4. Sinan Yashar Abdula, i biri i Yashar dhe Perini, shtetas turk, i datëlindjes 1973, lindur në Bagdat dhe banues në Stamboll (Turqi), person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportës me nr. H 0310909, përfaqësuar me autorizim nr. 28447, datë 08.12.2003 nga Z. Ömer Satin.

si themelues të Shoqërisë Anonime "BT International Engineering Services Limited & Arun Construction Joint Stock Company" Sh.a, kanë vendosur sa më poshtë:

**KAPITULLI I
Forma ligjore, emërtimi, selia e shoqërisë**

**Neni 1
Forma juridike**

Në mbështetje të vullnetit të aksionerëve themelues të shprehur në aktin e themelimit si dhe në pajtim të plotë me dispozitat e Ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare", themelohet Shoqëria Tregtare "BT International Engineering Services Limited & Arun Construction Joint Stock Company" Sh.a., e cila do të funksionojë sipas dispozitave të aktit të themelimit dhe këtij statuti.

Neni 2

Objekti i veprimtarisë

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë:

- Eksport + importi i karburantëve dhe nënprodukteve të tyre, hidrokarbureve në përgjithësi;
- Përpunim, rafinim i naftës dhe nëpëroducteve të saj;
- Shitje me pakicë të karburanteve të të gjitha llojeve;
- Blerjen, importimin, eksportim, shitjen e naftës, gazit, nënprodukteve të tyre, dhe vajrave mineralë të papërpunuar;
- Blerjen, importimin, eksportimin, transportimin, edhe për llogari të të tretëve, depozitimin, përzierjen, trajtimin, shitjen, shpërndarjen me shumicë të qymyrit, gazit, lubrifikantëve, produkteve të naftës dhe naftokimike, duke përfshirë këtu dhe bitumet;
- Blerjen, shitjen, qeradhënien, ndërtimin dhe administrimin e impianteve, depozitave dhe administrimin e ndërtesave dhe pasurive të veta të paluajtshme;
- Gjithashtu shoqëria do të mund të kryejë të gjitha ato veprime që organet drejtuese i konsiderojnë të nevojshme, ose të dobishme për arritjen e qëllimit të shoqërisë, përfshi këtu edhe lëshimi i dorëzaneve dhe i garancive të tjera.

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj pas marrjes dhe në përputhje me liçensat apo lejet përkatëse.

Neni 3

Emërtimi dhe afati

Emërtimi i shoqërisë do të jetë Shoqëria Tregtare "BT International Engineering Services Limited & Arun Construction Joint Stock Company" sh.a.

Afati kohor i zhvillimit të aktivitetit do të jetë i pakufizuar.

NENI 4

Selia dhe Zyrat e Përfaqësimit

Selia e Shoqërisë do të jetë në Qytetin e Tiranës, në adresën Rruga "Dëshmorët e 4 Shkurtit", Pall 'Sky Tower', Ap. nr. 6.

Veprimtaria e shoqërisë në tërë territorin e Republikës së Shqipërisë kryhet nga degët e saj, të cilat funksionojnë në rrethe apo ndarje të tjera administrative të Republikës së Shqipërisë nën drejtimin e Drejtorisë.

Shoqëria mund të çelë degë dhe zyra përfaqësimi të reja jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Ato hapen dhe prishen me vendim të Këshillit Mbikqyrës.



KAPITULLI II
KAPITALI THEMELTAR, AKSIONET
NDRYSHIMET E KAPITALIT



Kapitali themeltar i shoqërisë është 2 000 000 lekë.

Ai është i ndarë, në 2 000 aksione të së njëjtës kategori me vlerë nominale prej 1000 lekë, për çdo aksion të shlyer për tërësinë e vlerës nominale të tyre. Aksionet janë të numërtuara nga 1 deri 2 000 aksione.

Aksionerët themelues të Shoqërisë Tregtare “BT International Engineering Services Limited & Arun Construction Joint Stock Company” Sh.a zotërojnë aksionet në këtë shoqëri si më poshtë:

1. Zoti Rezart Taçi, zotëron 40 %, të vlerës së aksioneve në kapitalin fillestar të Shoqërisë të barabartë me 800 numër aksionesh.
2. Zoti Ómer Satin, zotëron 40 %, të vlerës së aksioneve në kapitalin fillestar të Shoqërisë të barabartë me 800 numër aksionesh.
3. Zoti Riza Aydın Arun, zotëron 15 %, të vlerës së aksioneve në kapitalin fillestar të Shoqërisë të barabartë me 300 numër aksionesh.
4. Zoti Sinan Yashar Abdula, zotëron 5 %, të vlerës së aksioneve në kapitalin fillestar të Shoqërisë të barabartë me 100 numër aksionesh.

Neni 6

Forma e aksioneve

Aksionet e Shoqërisë janë nominative.

Pronësia e aksioneve vërtetohet nga regjistrimi i tyre në emër të pronarëve në regjistrin e mbajtur për këtë qëllim nga Shoqëria, sipas mënyrës të parashikuar me ligj. Me kërkesën e aksionerit, Shoqëria lëshon një vërtetim të regjistrimit të aksioneve në pronësi të tij. Aksionet janë të pandashme.

Neni 7

Shitja dhe transferimi i aksioneve

Përveç rastit të trashëgimisë, transferimi i pronësisë mbi aksionet e një të treti, pavarësisht nga baza juridike e këtij transferimi, duhet të miratohet nga Këshilli Mbikqyrës në kushtet dhe sipas procedurave të parashikuara në nenin 207 të ligjit “Për Shoqëritë Tregtare”.

Në qoftë se Këshilli Mbikqyrës ka refuzuar shitjen e aksioneve një blerësi jashtë bashkësisë së aksionerëve, shitësi duhet të njoftojë shoqërinë me letër rekomande brenda 8 ditëve nga data e njoftimit të realizimit, nëse ka hequr dorë nga projekti i shitjeve të aksioneve. Në rast se shitësi nuk ka hequr dorë nga ky projekt, Këshilli Mbikqyrës duhet të sigurojë blerjen e aksioneve prej një ose disa persona të zgjedhur prej tij.

Në qoftë se, për vlerësimin e aksioneve nevojitet një akt ekspertimi shpenzimet e ekspertit paguhen përgjysëm të ndara midis shitësit dhe blerësit.

Neni 8

Zmadhimi i kapitalit themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë mund të zmadhohet sipas mënyrave dhe rregullave të parashikuara në nenet 150 deri 163 të ligjit Nr.7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare".

Zmadhimi i kapitalit themeltar mund të bëhet vetëm me Vendim të Asamblesë të Jashtëzakonshme të Aksionerëve, në bazë të raportit të Drejtorisë, të hartuar në mënyrën e kërkuar nga ligji.

Aksionerët kanë të drejtën e përparësisë për nënshkrimin e aksioneve të shlyeshme në para që emetohen për zmadhimin e kapitalit. Kjo e drejtë është në përpjestim me shumën e aksioneve të zotëruara nga aksioneri përpara zmadhimit të kapitalit.

Aksionerët mund të heqin dorë vetëm individualisht nga e drejta për nënshkrimin e aksioneve të reja. Ata, gjithashtu, kanë të drejtë të kërkojë nënshkrimin e një numri me të vogël aksionesh nga sa ju takon sipas parimit të përpjestueshmërisë, por me kusht që Asamblea të ketë vendosur shprehimisht për këtë gjë.

Neni 9

Shlyerja e aksioneve

Aksionet për kapitalin në para të nënshkruara në zbatim të një vendimi për zmadhimin e kapitalit do të shlyhen për 100 përqind të vlerës së tyre qysh në çastin e nënshkrimit. Asamblea e Jashtëzakonshme që vendos zmadhimin e kapitalit, ka të drejtë të marrë vendimin për shlyerjen tërësore të aksioneve qysh në çastin e nënshkrimit, ose brenda një afati të shkurtër.

Kërkimi i fondeve u njoftohet nënshkruesve të paktën 15 ditë përpara datës së caktuar për çdo derdhje, me letër rekomande dhe me kthim përgjigje, drejtuar çdo pronari të aksioneve.

Çdo vonesë në derdhjen e shumave të kërkuara sjell pagimin e interesave sipas përqindjeve të caktuara me ligj, duke filluar nga data e kërimit të çdo derdhjeje pa qënë nevoja për të proceduar në formalitete të tjera të ç'farëdoshme dhe pa hequr dorë nga veprimet e Shoqërisë ndaj aksionerit detyruar dhe nga masat e zbatimit të detyruar të parashikuara, nga ligji.

Neni 10

Zvogëlimi i kapitalit themeltar

Zvogëlimi i kapitalit themeltar të shoqërisë kryhet vetëm me Vendim të Asamblesë të Jashtëzakonshme të Aksionerëve dhe në pajtim me dispozitat e neneve 164 deri 166 të ligjit Nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare". Zvogëlimi i kapitalit themeltar nuk duhet të çënojë raportin e aksionerëve para këtij zvogëlimi.

Kapitali themeltar nuk mund të zvogëlohet nën shumën minimale të kërkuar nga ligji.

Neni 11

Të drejtat dhe detyrimet e lidhura me aksionet

Çdo aksion jep të drejtën e pjesmarrjes në fitimet vjetore të shoqërisë të destinuara për shpërndarje dhe në tepricën e aktivitetit të mbetur në rastin e likuidimit në përpjestim me aksionet që zotëron. Pronësia mbi aksionet jep edhe të drejtën e votës dhe të përfaqësimit në mbledhjet e asamblesë së përgjithshme në kushtet e përcaktuara në ligj dhe në statut.

Aksionerët përgjigjen për detyrimet e shoqërisë ndaj të tretëve dhe për humbjet e saj deri në masën e shumës nominale të aksioneve që zotëron. Ndalohet kërkimi i fondeve të kësaj shume.

Kur aksionet u kalojnë aksionerëve të rinj, këta ruajnë të drejtat e detyrimeve që vijnë nga aksionet. Pronësia e një aksioni përmban automatikisht të drejtën e aderimit në statutin e shoqërisë dhe në vendimet e asamblesë së përgjithshme.

KAPITULLI III DREJTIMI I SHOQËRISË

Seksioni I

Drejtoria

Neni 12

Përbërja dhe emërimi

Drejtimi i përgjithshëm i shoqërisë kryhet nga Drejtoria.

Drejtori Ekzekutiv emërohet dhe shkarkohet nga Këshilli Mbikqyrës.

Drejtor Ekzekutiv i Shoqërisë Tregtare "BT International Engineering Services Limited & Arun Construction Joint Stock Company" Sh.a. do të jetë Zoti Rezart TAÇI.

Drejtori i ushtron funksionet e tij nën kontrollin e Këshillit Mbikqyrës.

Neni 13

Kohëzgjatja e funksioneve të Drejtorisë.

Drejtori emërohet për një periudhë të 6 vjeçare.

Ai mund të shkarkohet nga detyra e tij me vendim të Këshillit Mbikqyrës për shkakë të përligjura.

Në qoftë se vendi i drejtorit mbetet bosh, zëvendësimi i tij bëhet nga Këshilli Mbikqyrës.

Anëtarit zëvendësues emërohet për periudhën që mbetet deri në emërimin pasardhës të anëtarit tjetër të drejtorisë.

Neni 14

Shkarkimi i Drejtorit Ekzekutiv

Drejtori mund të shkarkohet gjatë mandatit të tij :

1. Është shpallur fajtor me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një vepre penale që ka lidhje me veprimtarinë ekonomiko- financiare.
2. Është vërtetuar se ka shpërdoruar fondet e shoqërisë.



3. Janë raste të parashikuara në nenin 98 të Ligjit Nr.7638, datë 19. 11. 1992 "Për Shoqëritë Tregëtare".

Neni 15
Përfaqësimi i shoqërisë

Shoqëria përfaqësohet para të gjitha institucioneve publike e private, organeve gjyqësore si dhe në marrëdhëniet me të tretët nga Z. Rezart Taçi dhe Z. Ömer Satin, të cilat kanë të drejtë të e përfaqësojnë shoqërinë dhe të nënshkruajnë aktet përkatëse të dy së bashku ose secili veç e veç.

Neni 16
Mbledhjet e drejtorisë dhe vendimet

Mbledhja e drejtorisë drejtohet nga Drejtori i saj ose personi i autorizuar rregullisht prej tij.

Mbledhjet e drejtorisë zhvillohen, si rregull, në selinë e shoqërisë. Ato drejtohen nga Drejtori i saj që kryen edhe procedurat e nevojshme për thirrjen e mbledhjes.

Neni 17
Kompetencat e Drejtorisë

Drejtori ka kompetenca të plota për të vepruar në emër të shoqërisë në çdo rrethanë. Ai i ushtron këto kompetenca brenda kufijve të objektit të shoqërisë, dhe kufizohet nga ato kompetenca që ligji ua jep shprehimisht Këshillit Mbikqyrës dhe Asambleve të Aksionerëve.

Neni 18
Operacione të autorizuar

Drejtorja kërkon autorizim paraprak nga Këshilli Mbikqyrës për :

- a. krijimin e garancive me anë të pasurisë së shoqërisë.
- b. kryerja e investimeve që nuk përfshihen në programin financiar vjetor.
- c. çeljen e veprimtarive ose degëve e agjencive të reja;
- ç. shkrija, bashkimi dhe mbyllja tërësisht ose pjesërisht e veprimtarive dhe degëve të shoqërisë.
- d. pjesëmarrja në shoqëri të tjera.
- e. shitja dhe shkëmbimi i pasurive që përbëjnë aktive të qëndrueshme të shoqërisë.
- f. lidhjen ose ndryshimin e kontratave që kapërcejnë vlerën e caktuar nga Këshilli Mbikqyrës.

Kur Këshilli Mbikqyrës refuzon të japë autorizimin e kërkuar, Drejtorja mund t'i kërkojë aksionerëve të urdhërojnë Këshillin Mbikqyrës të lëshojë autorizimin ose ta autorizojnë vetë.



Neni 19

Shpërblimi i Anëtarit të Drejtorisë

Masa e shpërblimit të drejtorit caktohet nga Mbledhja e Asamblesë së Aksionerëve.

Neni 20

Përgjegjësia e Anëtarëve të Drejtorisë

Anëtarët e Drejtorisë janë përgjegjës, civilisht dhe penalisht për aktet e drejtimit të tyre, në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Seksioni 2 Këshilli Mbikqyrës

Neni 21

Përbërja dhe emërimi

Këshilli Mbikqyrës përbëhet nga tre anëtarë. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës emërohen nga Asambleja e Aksionerëve dhe 2/3 e tyre nuk kanë statusin e të punësuarit në shoqëri.

Neni 22

Person Juridik anëtar i Këshillit Mbikqyrës

Një person juridik që është aksioner i shoqërisë nuk mund të jetë anëtar i Këshillit Mbikqyrës. Në këtë rast ky duhet të caktojë, qysh në çastin e zgjedhjes, një përfaqësues të përhershëm person fizik, i cili u nënshtrohet të njëjtave kushte dhe detyrimeve dhe ka të njëjta përgjegjësi civile e penale si të ishte ai vetë anëtar i Këshillit, duke mos përjashtuar nga përgjegjësia e përbashkët edhe personin juridik që ai përfaqëson. Në qoftë se personi juridik i revokon mandatin përfaqësuesit të tij, ai duhet të njoftojë për këtë shoqërinë pa vonesë dhe të bëjë zëvendësimin e tij. Ky rregull do të zbatohet edhe në rastet e vdekjes, të dorëheqjes ose të pengimeve të zgjatura të përfaqësuesit të përhershëm.

Neni 23

Kohëzgjatja e funksioneve dhe vendet bosh

Kohëzgjatja e funksioneve të anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës është tre vjet por asnjëherë s' duhet të kalojë 6 vjet.

Në qoftë se një ose disa vende të anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës të zgjedhur nga asambleja mbeten bosh për shkak të vdekjes, dorëheqjes ose një pengimi për një kohë të gjatë, Këshilli njofton Asamblenë e Aksionerit, i cili bën zëvendësimet përkatëse.

Neni 24

Kryetari dhe Zëvendëskryetari i Këshillit Mbikqyrës

Këshilli Mbikqyrës, nga përbërja e tij ka një kryetar dhe një zëvendëskryetar që ngarkohen me organizimin dhe zhvillimin e mbledhjeve të Këshillit.



Kryetari dhe Zëvendëskryetari i Këshillit Mbikqyrës janë persona fizike dhe nuk mund të zgjidhen ndërmjet përfaqësuesve të personave juridike apo anëtarëve të zgjedhur nga të punësuarit e shoqërisë.

Ata ushtrojnë funksionet e tyre gjatë tërë periudhës së mandatit të dhënë.

Kryetari dhe zëvendëskryetari i Këshillit Mbikqyrës mund të rizgjidhen.

Këshilli Mbikqyrës mund të emërojë një sekretar të zgjedhur midis anëtarëve të Këshillit ose jashtë tyre duke caktuar edhe kohëzgjatjen e funksioneve të këtij.

Neni 25

Mbledhjet e Këshillit Mbikqyrës. Quorumi

Këshilli Mbikqyrës mblidhet me thirrjen e kryetarit, ose në rast pengimi të këtij, të zëvendëskryetarit, sa herë që e kërkon interesi i shoqërisë dhe sa herë shtrohen çështje për t'u zgjidhur dhe që janë në kompetencë të këtij Këshilli. Në çdo rast Këshilli duhet të mblidhet detyrimisht një herë në tre muaj. Thirrja e Këshillit bëhet me çdo lloj mënyre.

Kryetari i Këshillit Mbikqyrës, duhet të thërrasë mbledhjen e Këshillit brenda 15 ditësh kur Drejtori ose një e treta e anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës i paraqit një kërkesë të motivuar për këtë. Në qoftë se kërkesa nuk merr përgjigje, kërkuetit mund të procedojnë vetë me thirrjen e mbledhjes të Këshillit Mbikqyrës, duke treguar rendin e ditës të mbledhjes.

Mbledhjet e Këshillit Mbikqyrës mbahen në selinë, e shoqërisë.

Rendi i ditës vendoset nga kryetari ose, në mungesë të tij nga zëvendëskryetari, ose nga anëtari i drejtorisë apo anëtarët e Këshillit Mbikqyrës që kanë kërkuar thirrjen e mbledhjes.

Çdo anëtar i Këshillit Mbikqyrës mund t'i japë mandat një anëtari tjetër për t'a përfaqësuar në një seancë të Këshillit. Çdo anëtar mund të japë vetëm një mandat për të njëjtën seancë.

Shqyrtimet dhe vendimet e Këshillit Mbikqyrës janë të vlefshme kur numri i anëtarëve të pranishëm, në mbledhje është të paktën sa gjysma e anëtarëve në funksion.

Vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm dhe të përfaqësuar.

Në rast votash të barabarta ajo e kryetarit është përcaktuese.

Në selinë e shoqërisë mbahet një regjister i pranishëm, i cili firmoset nga anëtarët e Këshillit pjesmarrës në seancë.

Shqyrtimet dhe vendimet e Këshillit Mbikqyrës evidencohen me procesverbale të hartuara në një regjistër të posaçëm, i numërtuar dhe i vulosur, që mbahet në selinë e shoqërisë, në të cilin tregohen anëtarët e pranishëm, të përfaqësuar dhe që mungojnë si dhe çdo person që ka asistuar në mbledhje, tërësisht apo pjesërisht.

Proces verbalet firmosen nga të gjithë anëtarët e pranishëm.

Neni 26

Kompetencat e Këshillit Mbikqyrës

Këshilli Mbikqyrës ushtron mbikqyrje në mënyrë të përhershme në drejtimin dhe administrimin e shoqërisë nga ana e Drejtorisë. Ai vendos për operacionet që duhet të kryhen me autorizim të tij në bazë të nenit 19 të këtij statuti.

Këshilli Mbikqyrës miraton programet vjetore të zhvillimit të shoqërisë si dhe planin e saj ekonomiko-financiar dhe ia paraqet për miratim, përfundimisht Asamblesë së Aksionerit të Vetëm. Këshilli Mbikqyrës miraton strukturën organizative të shoqërisë dhe ndryshimet e saj, kriteret e punësimit dhe të pagave si dhe rregulloren e brendëshme të shoqërisë.

Në çdo kohë të vitit, Këshilli Mbikqyrës kryen të gjitha verifikimet dhe kontrollet që ai i çmon të arsyeshme dhe ka të drejtë të kërkojë të njihet me dokumentet që ai gjykon të nevojshme për përmbushjen e funksioneve të tij. Një herë në tre muaj ai merr një raport të paraqitur nga Drejtori. Brenda tre muajve nga mbyllja e çdo viti financiar Drejtori i paraqit atij me qëllim verifikimi e kontrolli, llogaritë vjetore si dhe një raport të shkruar për gjendjen e shoqërisë dhe aktivitetet e saj gjatë vitit financiar të mbyllur.

Neni 27

E drejta për informim e anëtarëve të Këshillit

Çdo anëtar i Këshillit Mbikqyrës ka të drejtë të kërkojë dhe të marrë nga Drejtori informacion për çështje të natyrës administrative, teknike dhe financiare që i mundësojnë atij të verifikojë dhe gjykojë për kushtet në të cilat zhvillohet veprimtaria e shoqërisë dhe të jetë plotësisht i qartë për vendimet që duhen marrë apo që do të merren nga ana e Këshillit.

Kryetari i Këshillit ka përgjegjësinë për t'i vënë anëtarët e Këshillit në gjendje që të, marrin informacionet e kërkuara.

Çdo anëtar i Këshillit duhet të njoftohet personalisht për mbledhjet e Këshillit dhe t'i vihen në dispozicion në selinë e shoqërisë apo t'i dërgohen bashkë me thirrjen dokumentet dhe raportet që do të shqyrtohen në mbledhje.

Shoqëria nuk është e detyruar t'i japë anëtarëve të Këshillit drejtues kopjo të proces verbaleve të vendimeve të Këshillit, por çdo anëtar mund të kërkojë që të njihet me to në selinë e shoqërisë.

Mosnjohja e të drejtave të çdo anëtari të Këshillit për informacionet e mësipërme dhe mos thirrja në mbledhjen e Këshillit sjell pavlefshmërinë e vendimeve të Këshillit.

Neni 28

Shpërblimi për anëtarësinë në këshill dhe shpërblimet e jashtëzakonshme

Asambleja e Zakonshme e Aksionerëve, mund t'u caktojë anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës si shpërblim për pjesëmarrjen në këshill një shumë vjetore fikse, e cila mbetet e pandryshuar deri në një vendim të kundërt të Asamblesë.

Këshilli Mbikqyrës mund të caktojë shpërblime të jashtëzakonshme për anëtarët të cilëve u ngarkohen shërbime apo detyra të caktuara. Shpërblimet e jashtëzakonshme i nënshtrohen miratimit nga Asambleja e zakonshme sipas rregullave të parashikuara nga nenet 122 deri 125 të ligjit "Për Shoqëritë Tregtare".

Shpërblimet e veçanta dhe të jashtëzakonshme përballohen nga llogaria e shoqërisë dhe kalohen në shpenzimet e saj.

Përveç shpërblimeve të përmendura në këtë nen, anëtarëve të Këshillit nuk u caktohet asnjë shpërblim tjetër i përhershëm ose jo.



Seksioni 3
**DISPOZITA TË PËRBASHKËTA PËR DREJTORINË DHE ANËTARËT E
KËSHILLIT MBIKQYRËS**

Neni 29

Marrëveshjet që kërkojnë autorizim

Çdo marrëveshie ndërmjet shoqërisë dhe Drejtorit ose Këshillit Mbikqyrës, që lidhet drejtpërdrejtë, apo me të cilën një nga personat e sipërpërmendur lidhet indirekt apo nëpërmjet një personi ndërmjetës të autorizohet paraprakisht nga Këshilli Mbikqyrës. Kryetari i Këshillit Mbikqyrës njofton ekspertin kontabël të autorizuar për marrëveshjet e autorizuara një muaj përpara se marrëveshja të lidhet dhe i shtron këto marrëveshje për miratim Asamblesë.

Ekspertët Kontabël të Autorizuar i paraqitin Asamblesë një raport të posaçëm për këto marrëveshje, e cila vendos mbi këtë raport. Dispozitat e mësipërme nuk zbatohen për marrëveshjet që kanë të bëjnë me operacionet rrjedhëse dhe të kryera në kushte normale.

Neni 30

Marrëveshjet e ndaluara

Anëtarëve të Drejtorisë dhe të Këshillit Mbikqyrës, u ndalohe të kontraktojnë që të marrin hua nga shoqëria, t'u akordohet nga shoqëria një zbulim me llogari rrjedhëse ose në një formë, tjetër, si dhe të bëjnë shoqërinë dorëzanëse apo garante për detyrimet e tyre ndaj të tretëve.

Kjo dispozite nuk zbatohet në rastin kur këta persona kontraktojnë me shoqërinë për marrjen e tyre në sigurim apo për marrjen e veprimtarive dhe mallrave që lidhen me këto veprimtari në sigurim ose që lidhen direkt me karakterin e tyre diagnostikues dhe kurues. Ky ndalim zbatohet për përfaqësuesit e përhershëm të personave juridike anëtarë të Këshillit Mbikqyrës si dhe për bashkëshortet, paraardhësit dhe, pasardhësit e personave të përmendur në këtë nen si dhe për çdo person ndërmjetës.

Neni 31

Detyrimet për ruajtjen e sekretit


Drejtori dhe anëtarët e Këshillit Mbikqyrës si dhe çdo person tjetër që asiston në mbledhjet e këtyre, organeve duhet të ruajnë fshetësinë për çështjet dhe të dhënat që kanë karakter të brendëshëm.

**KAPITULLI IV
Asambleja e Aksionerëve**

Neni 32

Mbledhjet e Asamblesë dhe efektet detyruese të vendimeve

Mbledhjet e Asamblesë së Aksionerëve janë të zakonshme ose të jashtëzakonshme në vartësi të natyrës të çështjeve që diskutohen dhe vendimeve që do të marrë.



Çdo asamble e mbledhur rregullisht përfaqëson tërësinë e aksioneve të zotëruara nga aksionerët.

Neni 33

Organizimi i mbledhjeve të Asamblesë

Asamblea thirret nga Këshilli Mbikqyrës ose nga drejtoria. E drejta për thirrjen e mbledhjes nga Drejtoria bëhet mbi bazën e rregullave të funksionimit të saj si organ kolegjal. Mbledhja e Asamblesë mund të thirret, gjithashtu, nga Eksperti Kontabël i Autorizuar i pavarur në raste urgjence, nga një mandatmbajtës i caktuar nga gjykata dhe kur është rasti, nga likuiduesi.

Asamblea mbledhet në selinë e shoqërisë ose në çdo vend tjetër të treguar në thirrje. Thirrja e Asamblesë së aksionerëve bëhet me anë të njoftimit që i dërgohet atij në adresën e tyre me leter rekomande.

Njoftimi duhet të bjerë në dorën e aksionerit apo të njihet prej tyre 15 ditë përpara mbledhjes së Asamblesë dhe duhet të përmbajë ditën, orën dhe vendin e mbledhjes, natyrën e Asamblesë, dhe rendin e ditës.

Kur asambleja e mbledhur nuk ka mundur të marrë vendim për shkak se nuk është siguruar quorumi i kerkuar, mbledhja e dytë thirret jo më vonë se një muaj nga data e thirrjes së parë në të njëjtat forma si e para. Njoftimi ose letrat e thirrjes të mbledhjes së dytë rikujtojnë datën dhe rendin e ditës.

Neni 34

Rendi i ditës

Rendi i ditës së mbledhjes së Asamblesë përcaktohet nga autori i thirrjes.

Aksionerët përcaktojnë rendin e ditës.

Keto projektrezoluta dërgohen në selinë e shoqërisë të shoqëruara me një kerkese në të cilën tregohen edhe arsyet, si dhe me një dokument që provon zoterimin e pjesës të kapitalit themeltar të kerkuar nga paragrafi i dytë i këtij neni.

Projektrezolutat dhe dokumentet shoqëruese duhet të mberijne në selinë e shoqërisë të pakten 5 dite përpara datës së mbledhjes së Asamblesë.

Asambleja e Aksionerëve nuk mund të marrë, në shqyrtim një çështje që nuk është përfshirë në rendin e ditës. Megjithatë ajo mundet, në çdo rrethane të shkarkojë një ose disa anëtarë të Këshillit Mbikqyrës dhe të beje zëvendesimin e tyre.


Neni 35

Evidenca e pjesëmarrjes, drejtimi i mbledhjes dhe proces - verbalet.

Për çdo mbledhje të Asamblesë mbahet një flete-pranie e cila përmban treguesit që provojnë identitetin e Aksionerëve dhe aksionet e zotëruara prej tyre. Flete-prania firmoset në anë nga aksioneri ose, kur është rasti, nga përfaqësuesi i tij dhe vërtetohet për saktësinë e saj nga komisioni vëzhgues i mbledhjes.

Për çdo mbledhje të Asamblesë hartohet një proces verbal i cili përmban :

- datën dhe vendin e mbledhjes;
- mënyrën e thirrjes;



- rendin e ditës;
- drejtuesi i mbledhjes dhe komisioni i vëzhgimit;
- numri i Aksionerëve që marrin pjesë në votim;
- quorumi i arritur;
- përmendjen e dokumenteve dhe të raporteve që janë shtruar në mbledhje;
- një përmbledhje të debeteve;
- tekstet e projektrezolutave të vëna në votim, ato të miratuara dhe ato të hedhura poshtë nga aksionerët;
- rezultatet e votimeve

Proçes verbalët e mbledhjes së Asamblesë hartohen në një regjistër të posaçëm, i numërtuar dhe i vulosur, i cili ruhet në selinë e shoqërisë.

Neni 36

Quorumi, votimi, numri i votave

Në Asamblenë e zakonshme dhe të jashtëzakonshme, quorumi llogaritet për tërësinë e aksioneve që përbëjnë kapitalin themeltar të shoqërisë.
E drejta e votes që u perket aksioneve është përpjestimore me kapitalin që ato perfaqësojnë.

Neni 37

Asambleja e Zakonshme

Asambleja e zakonshme mbledhet të paktën një herë në vit, brenda 6 muajve të vitit pasardhës, për të vendosur mbi llogaritë e shoqërisë për ushtrimin financiar të mbyllur.

Ajo ka ndër të tjera, kompetencat që vijojnë:

- të miratojë strategjinë e zhvillimit afatgjatë të shoqërisë;
- të miratojë plan-biznesin dhe planin financiar vjetor;
- të miratojë, ndryshojë ose të hedhe poshtë llogaritë vjetore që janë shtruar për miratim;
- të vendosë për shpërndarjen dhe destinimin e rezultatin në pajtim me dispozitat ligjore dhe me statutin;
- të emërojë dhe shkarkojë anëtarët e Këshillit Mbikqyrës;
- të shkarkojë me propozim të Këshillit Mbikqyrës, anëtarët e Drejtorisë;
- të emërojë Ekspertin ose Ekspertët Kontabël të Autorizuar;
- të miratojë ose të mos miratojë emërimet e anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës të kryera nga vetë Këshilli si emërimet të përkohshme;
- të miratojë pagën e drejtorit të saj dhe raportet e pagave për kategoritë e tjera të personelit të shoqërisë si dhe shpërblimet suplementare që mund të jepen për punë ose rezultate të mira;
- të caktojë shpërblimin e zakonshëm dhe shpërblime të tjera të parashikuara në këtë statut për Këshillin Mbikqyrës;
- të vendosë për raportin e Ekspertit Kontabël të Autorizuar lidhur me marrëveshjet që i nënshtrohen autorizimit paraprak të Këshillit Mbikqyrës.

Asambleja e zakonshme merr çdo vendim që nuk sjell ndryshime të statutit. Ajo merr vendime të vlefshme në mbledhjen e parë vetëm, kur aksioneret e pranishëm ose të përfaqësuar zotërojnë jo më pak se 50 për qind të aksioneve me të drejtë vote.

Në rast se mbledhja e parë nuk realizohet, për mbledhien e dytë nuk kërkohet asnjë lloj quorumi.

Asambleja e zakonshme merr vendim me shumicën e votave që zotërojnë aksionerët e pranishëm apo të përfaqësuar.

Neni 38

Asambleja e jashtëzakonshme.

Asambleja e jashtëzakonshme mbledhet sa here që duhet të merret një vendim që sjell ndryshime të këtij statuti.

Ajo nuk mund të shtojë detyrimet e aksionerëve përveç operacioneve që rrjedhin nga rigrupimi i aksioneve i kryer rregullisht.

Neni 39

Venia në dispozicion të Aksionerëve të dokumenteve dhe informacioneve

Shoqëria mban dhe vë në dispozicion të Aksionerëve, në kushtet dhe në afatet e parashikuara nga ligji, raportet, dokumentet dhe llogarite vjetore që shqyrton asambleja. Me përjashtim të inventareve dhe të ndonjë dokumenti tjetër të caktuar nga asambleja, dokumentet që duhet t'u vihen në dispozicion Aksionerëve u dërgohen këtij bashkë me njoftim-thirrjen për mbledhje.

KAPITULLI V

Kontrollorët e pavarur (Eksperti Kontabël i Autorizuar)

Neni 40

Emërimi dhe shpërblimi

Asambleja e Aksionerëve cakton një kontrollor të pavarur dhe një ndihmës të tij, të zgjedhur të dy nga listat e Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar. Në caktimin e kontrollorëve të pavarur mbahen parasysh përjashtimet dhe papajtueshmëritë e përcaktuara nga ligji nr.7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare"

Kontrollorët e pavarur caktohen për një kohë që i përgjigjet një ushtrimi financiar. Ata janë të ricaktueshëm.

Shpërblimi i kontrollorëve të pavarur caktohet nga asambleja e aksionerit të vetëm dhe përballohet nga shoqëria.

Shoqëria Tregtare "BT International Engineering Services Limited & Arun Construction Joint Stock Company" Sh.a. do të ketë një ekspert kontabël.

Eksperti i pare kontabël i Shoqërisë do të jetë Z. Paqsor Qato.



Neni 41

Detyrat dhe të drejtat

Detyrat dhe të drejtat e kontrollorëve të pavarur të shoqërisë janë ato të parashikuara nga ligji Nr.7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare".
Asambleja e Aksionerit mund t'u kërkojë kontrollorëve të pavarur kryerjen e kontrolleve apo verifikimeve të posaçme për çështje me interes të shoqërisë.
Ekspertët kontabël të autorizuar thirren në mbledhjen e Drejtorisë që mbyll llogaritë e vitit financiar të mbyllur si dhe në të gjitha Asamblea e Aksionerëve.
Me marrjen e raportit të ekspertëve kontabël të autorizuar asambleja miraton raportin dhe bilancin e shoqërisë. Raportet që ata përgatitin depozitohen në selinë e shoqërisë, në afatet e parashikuara nga ligji.

KAPITULLI VI LLOGARITË VJETORE, ÇAKTIMI I REZULTATIT

Neni 42

Viti financiar

Shoqëria përgatit çdo vit financiar llogarite vjetore në pajtim me ligjin për kontabilitetin. Viti financiar fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor.

Neni 43

Caktimi i rezultateve

Rezultati i vitit financiar nxirret dhe caktohet në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe mbas dhenies së raportit përfundimtar nga ekspertët kontabël të autorizuar.

KAPITULLI VII PRISHJA, LIKUJDIMI, KUNDËRSHTIMET

Neni 44


Prishja, likuidimi

Në rastin e prishjes të shoqërisë një ose disa likuidatore emerohen nga Asambleja e përgjithshme e Aksionerëve në kushtet e quorumit dhe me shumicën e parashikuar për Asamblea të përgjithshme të zakonshme. Likuidatori përfaqëson shoqërinë.
Ai ka kompetencën të plotë për të realizuar aktivin e shoqërisë, të shlyejë kreditorët dhe të shpërndajë mbetjen e disponueshme.
Ndarja e aktivit neto që mbetet pas rimbursimit të nominalit të aksioneve bëhet midis Aksionerëve në përpjestim me pjesëmarrjen e tyre në kapital.

Neni 45

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Te gjitha mosmarrëveshjet gjatë funksionimit të shoqërisë ose gjatë likuidimit të saj që lindin midis shoqërisë dhe Aksionerëve ose midis vetë Aksionerëve, lidhur me



veprimtarinë e shoqërisë, i nënshtrohen juridiksionit të gjykatave kompetente në kushtet e parashikuara nga legjislacioni shqiptar në fuqi.

KAPITULLI VIII EMËRIMET E PARA

Neni 46

Këshilli Mbikqyrës

Si anëtarë të Këshillit të parë Mbikqyrës emërohen nga aksionerët themelues të Shoqërisë "BT International Engineering Services Limited & Arun Construction Joint Stock Company" Sh.a. për një kohë prej tre vjetësh personat e mëposhtëm:

1. Omer Satin;
2. Mustafa Taçi;
3. Drita Aliçka.

të cilët kanë bërë të ditur që pranojnë funksionet respektive dhe pohojnë se nuk janë të prekur nga asnjë papajtueshmëri apo ndalim që pengon emërimin e tyre.

Neni 47

Ekspertët kontabël të autorizuar

Emërohet si Ekspert Kontabël i Autorizuar i parë për një kohë prej 1 (një) viti financiar: Z. Paqsor Qato i cili ka bërë të ditur që pranon funksionin e tij dhe pohon se nuk është i prekur nga asnjë papajtueshmëri apo ndalim që pengon emërimin e tij.

AKSIONERËT THEMELUES

Rezart TAÇI

Rezart Taçi

Riza Aydin ARUN
Përfaqësues me prokurë

Ömer SATIN

Ömer Satin

Ömer Satin

Ömer SATIN

Ömer Satin

Sinan Yashar ABDULA
Përfaqësues me prokurë

Ömer SATIN

Ömer Satin



Ömer Satin

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË
Nr. 8315 Rep.
Nr. 578 Kol.



V È R T E T I M

Sot më datë 09.07 2004, para meje noterit Agim Robo, Noter pranë Dhomës së Noterisë Tiranë, u paraqiten personalisht Rezart Taçi, i biri i mustafait, i datëlindjes 07.06.1971, lindur dhe banues në Tiranë, në adresën Rruga "Dervish Hima", Pall. "Klan", person madhor me zotësi të plotë juridik për të vepruar, mbajtës i pasaportës me nr. 1899916, Ömer Satin, i biri i Hysein, shtetas turk, i datëlindjes 10.02.1955, lindur në Ankara (Turqi) dhe banues në Stamboll (Turqi), person madhor me zotësi të plotë juridik për të vepruar, mbajtës i pasaportës me nr. 290374, te cilet më deklaruan përmbajtjen e këtij akti të hartuar jashtë kësaj zyre dhe të nënshkruar me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë dhe unë noteri e vërtetova atë sipas ligjit.



URDHER REGJISTRIMI

I	Nr. regjistrimi 31967.
II	<p>A. Emri "BT International Engineering Services Limited & Alun Construction Joint B. Selia ⁷⁷⁰⁰ Company" sh.a. Rrugja "Dëshmorët e "Shkëlzit" Pallati "Ishy Tovu" Nr. Nr. 6. Tiranë</p> <p>C. Objekti Ekspor - import i hollësive dhe shërbimeve të tjera, shërbime, regjistrim i regjistër dhe shërbimeve të tjera shërbimeve të tjera</p> <p>D. Kapitali 2 000 000 lekë i notuar në 2000 aksione me vlerë nominale 1000 lekë një aksioni 1000 lekë.</p> <p style="font-size: small; margin-left: 200px;"> - Rezervat Taz. 40% - Amer. Jani 40% - Rikthim Arsy. 15% - Shtetë Abdullë 5% </p>
III	<p>Administratori KM: 1. Dimes Saliq 2. Mustafa Hesi 3. Zikri Rizaj</p> <p style="margin-left: 100px;"> Dregjor: Petar Taz. dot IPT. banor. Ri: Jelena Hina palë K104. </p>
IV	<p>Kohezgjatja e përfundimit</p> <p>Akt - Themelimi 5 fletë</p> <p>Statuti 16 fletë</p>
V	<p>Nenshkrimi</p> <p>Statuti 09.07.04</p> <p>Akt - Themelimi 09.07.04</p> <p style="text-align: right; margin-right: 50px;">/ do-02.04.</p>

J. Amankhane

Nr. dregj. 412.17040.

Aktuarizim Nr. 32728
 dt. 1.11.02

Aktuarizim Nr. 28.447
 dt 08/12/03

GJYQTARE

Mariana Dedi

MARIANA DEDI

KËRKESË

KËRKUES: Rezart Taçi, i biri i mustafait, i datëlindjes 07.06.1975, lindur në banues në Tiranë, në adresën Rruga "Dervish Hima", Pall. "Klan", person i padhori me zotësi të plotë juridik për të vepruar, mbajtës i pasaportës me nr. 899916, me cilësinë e Drejtorit Shoqërisë Tregtare "BT International Engineering Services Limited & Arun Construction Joint Stock Company" sh.a.

OBJEKTI: Regjistrimin si person juridik në Regjistrin Tregtare, të Shoqërisë Tregtare "BT International Engineering Services Limited & Arun Construction Joint Stock Company" sh.a.

PËRPARA GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË

TIRANË

I nderuar Zoti Kryetar,

Ne mbështetje të ligjit Nr. 7638, datë 19.11. 1992 "Për Shoqëritë Tregtare", Zoti Rezart Taçi, me cilësinë e Drejtorit të Shoqërisë Tregtare "BT International Engineering Services Limited & Arun Construction Joint Stock Company" sh.a. kërkon regjistrimin e kësaj Shoqërie në Regjistrin Tregtar.

Shoqëria Tregtare "BT International Engineering Services Limited & Arun Construction Joint Stock Company" sh.a. do të ketë si objekt të veprimtarisë së saj:

- Eksport - importi i karburantëve dhe nënprodukteve të tyre, hidrokarbureve në përgjithësi;
- Përpunim, rafinim i naftës dhe nëpëroducteve të saj;
- Shitje me pakicë të karburanteve të të gjitha llojeve;
- Blerjen, importimin, eksportim, shitjen e naftës, gazit, nënprodukteve të tyre, dhe vajrave mineralë të papërpunuar;
- Blerjen, importimin, eksportimin, transportimin, edhe për llogari të të tretëve, depozitimin, përzjerjen, trajtimin, shitjen, shpërndarjen me shumicë të qymyrit, gazit, lubrifikantëve, produkteve të naftës dhe naftokimike, duke përfshirë këtu dhe bitumet;
- Blerjen, shitjen, qeradhënien, ndërtimin dhe administrimin e impianteve, depozitave dhe administrimin e ndërtesave dhe pasurive të veta të paluajtshme;
- Gjithashtu shoqëria do të mund të kryejë të gjitha ato veprime që organet drejtuese i konsiderojnë të nevojshme, ose të dobishme për arritjen e qëllimit të shoqërisë, përfshi këtu edhe lëshimi i dorëzanive dhe i garancive të tjera.

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj pas marrjes dhe në përputhje me licencat apo lejet përkatëse.



M. Jeci
2004

Be regjistrimit
M. Jeci
20.07.09.

Aksionerë themelues të Shoqërisë Tregtare "BT International Engineering Services Limited & Arun Construction Joint Stock Company" Sh.a. do të jenë zotërinjtë Rezart Taçi, Ömer Satin, Riza Aydin Arun dhe Sinan Yashar Abdula me pjesmarrje në kapitalin themeltar si më poshtë:

1. Zoti Rezart Taçi, zotëron 40 %, të vlerës së aksioneve në kapitalin fillestar të Shoqërisë të barabartë me 800 numër aksionesh.
2. Zoti Ömer Satin, zotëron 40 %, të vlerës së aksioneve në kapitalin fillestar të Shoqërisë të barabartë me 800 numër aksionesh.
3. Zoti Riza Aydin Arun, zotëron 15 %, të vlerës së aksioneve në kapitalin fillestar të Shoqërisë të barabartë me 300 numër aksionesh.
4. Zoti Sinan Yashar Abdula, zotëron 4 %, të vlerës së aksioneve në kapitalin fillestar të Shoqërisë të barabartë me 100 numër aksionesh.

Kapitali themeltar është në vlerën 2.000.000 lekë, i ndarë në 2000 aksione me vlerë nominale të një aksioni 1000 lekë.

Afati i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë për një periudhë kohore të pakufizuar. Selia e shoqërisë ndodhet në Qytetin e Tiranë Rruga "Dëshmorët e 4 Shkurtit" Pallati "Sky Toëer", Ap. Nr. 6.

Ogranet drejtuese të shoqërisë janë:

1. Asamblea e Aksionerëve;
2. Këshilli Mbikqyrës i përbërë nga tre anëtarë. Anëtarët e parë të Këshillit Mikqyrës janë zotërinjtë Ömer Satin, Mustafa Taçi dhe Drita Aliçka;
3. Drejtori i shoqërisë është Z. Rezart Taçi.
4. Eksperti kontabël i autorizuar Z. Paqsor Qato.

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetet në përputhje me Aktin e themelimit, Statutin dhe ligjin nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare".


Për sa më sipër meqënëse kërkesa jonë gjendet plotësisht e bazuar në kërkesat e ligjit nr. 7638 datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare", kërkojmë regjistrimin e Shoqërisë në Regjistrin Tregtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

K Ë R K U E S

Rezart TAÇI

Rezart

Taçi




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË
Nr. 8348 Rep.
Nr. 2 NOT Kol.
TIRANË


VËRTETIM

Sot më datë 07.07.2004, para meje noterit Agim Robo, Noter pranë Dhomës së Noterisë Tiranë, u paraqit personalisht Rezart Taçi, i biri i mustafait, i datëlindjes 07.06.1971, lindur dhe banues në Tiranë, në adresën Rruga "Dervish Hima", Pall. "Klan", person madhor me zotësi të plotë juridik për të vepruar, mbajtës i pasaportës me nr. 1899916, i cili më deklaroi përmbajtjen e këtij akti të hartuar jashtë kësaj zyre dhe të nënshkruar me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë dhe unë noteri e vërtetova atë sipas ligjit.

NOTER



NÖ 1553



T.C.
KADIKÖY 13. NOTERLİĞİ
Sütlüce Cad. Sıvket Bey Apt.
No: 12 Kat: 2 Kadıköy/İST
Tel: 345 84 85-418 13 42
Fax: 345 48 13

TEBECİNE

No:32729
1.11.2002

25 HAZ 2004

AUTORİZİM i PËRGJËTHSHËM

Unë i nënshkruari RIZA AYDIN ARUN me firmen regjistruar në Turqi në adresë Istanbul, Kadıköy, Kozyatağı, Kaya Sultan sokak No:93 D:6 781090 i jap autorizim shtetasit të Republikës së Turqisë ÖMER SATIN, për të vepruar në emrin tim brenda kufinjeve të Republikës së Shqipërisë në themelimin e çdo lloji te kompanisë, të mer pjesë me çfarëdo kapital apo letra me vlerë në kompanitë që do te themelohen, të nënshkron aktat e themelimit, shtesave dhe ndryshimeve të organizatës, të garanton ipjen e kapitalit, të mer leje për organizatë, të regjistron, te percjellë dhe të përfundon të gjitha procedurat që janë te nevojshme prej momentit te regjistrimit deri ne themelimin e kompanisë, të nënshkruajë dokumentet e duhur, të paguajë te gjitha taksat dhe shpenzimet; bazuar ne ligjet e Republikës së Shqipërisë.

RIZA AYDIN ARUN

Adres: Kaya Sultan Sokak No:93 D 6
Kozyatağı/Kadıköy/Istanbul

nënshkrimi



Vërtetohet se sot me datë 1.11.2002 para meje noteres u paraqit personalisht z. Rıza Aydın Arun, i lindur në vitin 1949 në Ankara, djali i Muharrem dhe Ayşe Nacioglu-it dhe regjistruar në komunë Antalya , për të dhënë autorizimin e sipërpërmendur, identitetin e të cilit e sigurova nga pasapoti të tij me numër TR-N No:467722 e vlefshme prej 26.09. 2002 deri 11.10.2005 dhe nga ana e drejtorisë së Punëve të brendshme të Stambullit.



REPUBLIKA SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERËVE TIRANË
Nr 8414 Rep Dt 12/11/02
VERTETIM

Vërtetohet se kjo kopje është e njëjtë me origjinalin. Dokumenti U. Pasaport T. Hoxha
Nr Pasaport
NOTER AGIM ROBO

Në vend të NOTERIT 6
KEMAL ERKEN
Autorizuari
ENDER TEZEL

İşbu belge ... tarafından ...
tarafından ... tarafından ...
Yeminli Tercüman



İşbu belgenin dairemin yeminli çevirmeni
Meral Tosala
tarafından Türkçe / Arnavutça
terjime edildiğini onaylım.



KADIKÖY 13. NOTERLİĞİ
NİHAL KILIC

25 HAZ 2004

T.C.
KADIKÖY S. NOTERLİĞİ
Büyükdere Cad. No:350/4
Erenköy - İSTANBUL
Tel:356 98 68

GENEL VEKALETNAME

01 KASIM 2002

Türkiye de İstanbul, Kadıköy, Kozyatağı, Kaya Sultan sokak No. 93 D. 6 - 7 81090 adresinde Ticari faal işyerim ve kurulu Şirketim olan ben RIZA AYDIN ARUN olarak şahsımı temsilen Arnavutluk sınırları içerisinde Arnavutluk kanunlarına göre her türlü Şirketler kurmaya, kurulacak şirketlere dilediği hisse ve dilediği sermaye ile iştirak etmeye, kuruluş sözleşmelerini, ek ve tadillerini imzalamaya, sermaye koymayı taahhüt etmeye, kuruluş izni almaya, tescil ettirmeye, şirketin kuruluş aşamasından Resmi sıfat kazanmasına kadarki tüm Devlet Daireleri ve Kurumlardaki tüm işlemleri takip ve tamamlamaya, belgeleri imzalamaya, ödenmesi gereken her türlü vergi, harç ve masrafları ödemeye, Arnavutluk Kanunlarına göre şirketin kurulması ve resmi sıfatını kazanması için yapılması gereken tüm işlemleri şahsımı temsilen yapıp yerine getirmeye yetkili olarak Türkiye Cumhuriyeti vatandaşı bay ÖMER SATIN şahsım tarafından vekil tayin edildi

VEKİL EDEN : **RIZA AYDIN ARUN** imzası


Adres:Kaya Sultan Sokak.No:93 D.6
Kozyatağı/Kadıköy/İstanbul



İşbu Vekaletname altındaki imzanın gösterdiği, İstanbul Valiliğinden 26.Eylül 2002 tarihinde TK-N No:467722 seri ve numara ile verilme fot.tas. 11.Ekim 2005 tarihine kadar geçerli olduğu bulunan pasaporta göre: Antalya nüfusuna kayıtlı bulunan Ayşe ile, Muharrem Naci oğlu, 1949 Ankara doğumlu, RIZA AYDIN ARUN'a ait işlerinin yoğunluğu nedeniyle mahallinde ve huzurunda bulunduğunu onaylarım. Bir Kasım ikibiniki Cuma.



M.K






TASDİK ŞERHİ

(5 Ekim 1961 tarihli Lahey Sözleşmesi)

APOSTILLE

(Convention de La Haye du 5 Octobre 1961)

- 1- Ülke TÜRKİYE - LA TURQUIE
işbu resmi belge: **Nihal**
- 2- **Kılıç** tarafından imzalanmıştır.
- 3- İmzalayanın sıfatı **Noter** dir.
- 4- **Kadıoğlu**'nin mühür/damgasını taşımaktadır
13. Noterliği TASDİK
- 5- **Kadıoğlu** 'da
- 6- **01.07.2004** günü
- 7- **Kaymakam** tarafından
- 8- No **642** ile tasdik edilmiştir.
- 9- Mühür Damga **10** imza



S. Saffet KARAKISARLI
Üstöğür Kaymakamı
Kadıoğlu Kaymakamı v.

Protercume®

Tercüme Hizmetleri
www.protercume.com info@protercume.com
Sığırtıoçeme cad. 30-8 Kadıköy İstanbul
Tel: 0 216 450 04 10-11

Nº 151



Y.C.
KADIKÖY 13. NOTERLIK
Nº: 28447
Date: 08- Dhjetorë-2003
Nazan Yavuz
Bağdat Cad. Vedat Han No: 52 K:2 Kadıköy İstanbul
Tel:0216 3382710



AUTORIZIM

REPUBLIKA SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERËVE TIRANË
Nr 8115 Rep Dt 12/7/04
VERTETIM

21 HAZ 2004

Vërtetohet se Sinan Yashar Abdula është me emër në listën e Dajkëve të U. Pavarur Nr Pasap T. Hajolari
NOTER AGIM ROBO

Unë i nënshkruari SINAN YASHAR ABDULA banues në adresë Ist.,Tevfikpaşa sok., no:4 D:12 Fenerbahçe Kadıköy tel:384 94 09 i jap autorizim shtetasit të Republikës së Turqisë ÖMER SATIN, për të vepruar në emrin tim brenda kufinjve të Republikës së Shqipërisë në themelimin e çdo lloji të kompanisë, të mer pjesë me çfarëdo kapital apo letra me vlerë në kompanitë që do të themelohen, të nënshkron aktat e themelimit, shtesave dhe ndryshimeve të organizatës, të garanton ipjen e kapitalit, të mer leje për organizatë, të regjistroj, të percjellë dhe të përfundon të gjitha procedurat që janë të nevojshme prej momentit të regjistrimit deri në themelimin e kompanisë, të nënshkruajë dokumentet e duhur, të paguajë të gjitha taksat dhe shpenzimet; bazuar në ligjet e Republikës së Shqipërisë.




Vërtetohet se sot me datë 08/12/2003 para meje noteres Nazan Yavuz u paraqit personalisht z. Sinan Yashar Abdula, i lindur në vitin 1973, djali i Yashar dhe Perini-it, për të dhënë autorizimin e sipërpërmendur, identitetin e të cilit e sigurova nga leja e banimit të tij me numër A 669111 (data e lëshuarjës 22.06.2002) i dhëne nga ana e drejtorisë së Punëve të brendshme të Stambollit.

Është bërë kjo kopje aslindan Aanawtca
tarafimdan Turkce terçume edildigini onaylarim.

[Signature]
Yeminli Tercüman

Yeminli Tercüman

Është bërë kjo kopje aslindan Turkce + Aanawtca
tarafimdan Hajolari terçume edildigini onaylarim.



KADIKÖY 13. NOTERLIK
MHAL KILIC



T.C.

M/1000

Tarih:08-Aralık -

KADIKÖY 7.NOTERİ
 NAZAN YAVUZ
 Bağdat Cad.Vedat Han
 no:53 K:2 Kızıltoprak,
 Kadıköy/İSTANBUL
 Tel:216-3382710

VEKALETNAME

Arnavutluk sınırları içerisinde Arnavutluk kanunlarına göre her türlü şirketler kurmaya, kurulacak şirketlere dilediği hisse ve dilediği sermaye ile iştirak etmeye, kuruluş sözleşmelerini, ek ve tadillerini imzalamaya, sermaye koymayı taahhüt etmeye, kuruluş izni almaya, tescil ettirmeye, şirketin kuruluş aşamasından resmi sıfat kazanmasına kadar ki tüm devlet daireleri ve kuruluşlarındaki tüm işlemleri takip ve tamamlanana, belgeleri imzalamaya, ödemesi gereken her türlü vergi, harca ve masrafları ödemeye, Arnavutluk Kanunlarına göre; şirketin kurmasına, resmî sıfatını kazanması için yapılması gereken tüm işlemlere şahsını temsil yapıp yerine getirmeye, mezun ve yetkili olmalarına Türkiye Cumhuriyeti Vatan-daşı Bay İOMER SATIN, tarafından vekil tayin edildi

VEKALET VEREN : SINAN YASHAR ABDULA
 ist., Tefrikpaşa sok., no:4 D:12 Fenerbahçe
 Kadıköy-tel:348 94 09

Sinan Yashar Abdula

[Signature]


İşbu vekaletname altındaki imzanın gösterdiği, ist.Emniyet müdürlüğünden 22.6.2002 tarih ve A 669111 seri no ile verilme fotoğrafı tasdikli ikamet tezkeresine göre; Yaşar ile Perin oğlu, Bağdat 1973 doğumlu SINAN YASHAR ABDULA'ya ait olup dairede ve huzurunda imzaladığını onaylarım. Sekiz Aralık ikibinüç Pazartesi.
 08/12/2003

P/T



KADIKÖY 7. NOTERİ
 NAZAN YAVUZ





TASDİK ŞERHİ

(5 Ekim 1961 tarihli Lahey Sözleşmesi)


APOSTILLE

(Convention de La Haye du 5 Octobre 1961)

- 1- Ülke TÜRKİYE - LA TURQUIE
İşbu resmi belge: *Nihal*
- 2- *Kılıç* tarafından imzalanmıştır.
- 3- İmzalayanın sıfatı *Noter* dir.
- 4- *Kadıkoş* nin mühür/dungasını taşımaktadır.

TASDİK

- 5- *Kadıkoş* 'da
- 6- *01-07-2004* günü
- 7- *Kaymakam* tarafından
- 8- *Kadıkoş* ile tasdik edilmiştir.
- 9- *Mühür*
- 10- İmza



S. Saffet Karahisarlı
İshidar Kaymakamı
Kadıkoş Kaymakamı V.